



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"
GJILAN



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
FERIZAJ

Duke qenë se në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan janë në funksion të plotë dy drejtime studimore në kuadër të Fakultetit të Edukimit (Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor);

Duke qenë se Fakulteti i Edukimit ka një specifikë tëveçantë për profilizimin e studentëve, që ka të bëjë me mbajtjen e mësimit praktik nëpër institucionale shkollore dhe ato parashkollore,

Duke qenë se në Fakultetin e Edukimit në të dy programet i vijojnë studimet edhe studentët nga komuna e Ferizajt, e të cilët rrjedhimisht do të ishte me e favorshme për ta mbajtja e mësimit praktik në institucionet shkollore dhe parashkollore në komunën nga vijnë;

E konsiderojmë të nevojshme të lidhim këtë

Universiteti Public "KADRI ZEKA" Public University	
Prahuar i mbi te	14.12.2020
Vesa e drejtuar	Nazim
Numri i shtresë	01/2207

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan
të përfaqësuar nga rektori, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

dhe

Drejtorisë Komunale të Arsimit në Ferizaj
të përfaqësuar nga drejtori, z. Afrim Llabjani

Neni 1

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan (UKZ), si entitet i ri i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, ka për qëllimtë vendosë raporte bashkëpunimi dhe partneriteti me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Ferizaj (DKA), për të siguruar përbushjen e planprogramit të Fakultetit të Edukimit, respektivisht pjesën programore përkizati me komponentin e mësimit praktik, si dhe krijimin e lehtësirave për mbajtjen e mësimit praktik për studentë që vijnë nga komuna e Ferizajt.

Neni 2

Thelbi i kësaj marrëveshje nënkuption vënien në shërbim të resurseve profesionale të stafit mësimdhënës dhe të stafit udhëheqës të shkollave filllore dhe të enteve parashkollore, të cilat drejtohen nga DKA.

Neni 3

Bashkëpunimi do të nënkuptojë pranimin dhe sistemimin e studenteve, për kohë të caktuar, në Institucionale shkollore dhe parashkollore dhe caktimin e mësuesve/edukatorëve në rolin e mentorëve për studentë që e mbajnë praktikën, duke u bazuar në planprogramet e Fakultetit të Edukimit, si dhe në Doracakun e mësimit praktik.

Neni 4

Duke e pasur parasysh që mësimi praktik është pjesë integrale dhe e detyrueshme e planprogramit të Fakultetit të Edukimit, interesni afatgjatë UKZ-së, është që kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi dhe partneriteti të mos jetë e kufizuar, respektivisht, kjo marrëveshje të jetë efektive për aq kohë sa do të ketë programe të akredituara të Fakultetit të Edukimit nga ana e Agjencisë së Akreditimit të Republikës së Kosovës.

Neni 5

UKZ merr përsipër dhe pajtohet të përbush detyrimet si në vijim:

- 5.1. UKZ të sigurojë përvaja të praktikës së mësimdhënies të një cilësie të lartë;
- 5.2. UKZ pajtohet që koordinatori i mësimit praktik të bashkëpunojë ngushtë me DKA-në, drejtorët e shkollave dhe enteve parashkollore, si dhe mësuesit/edukatorët mentorë për të siguruar që shkollat dhe entet parashkollore të janë të informuara për politikat dhe procedurat e mësimit praktik.
- 5.3. UKZ pajtohet që të sigurojë që mësimdhënësit e Fakultetit të Edukimit do t'i mbikëqyrin studentet gjatë mbajtjes së mësimit praktik sipas politikave të mësimit praktik të parapara me Doracakun emësimit praktik.
- 5.4. UKZ pajtohet të sigurojë që mësimdhënësit mbikëqyrës do të bashkëpunojnë ngushtë me mësimdhënësit dhe edukatorët mentorë, për të siguruar që ngritja profesionale e studentëve të jetë e udhëzuar dhe e mbikëqyrur sipas politikave të Fakultetit të Edukimit.

Neni 6

Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj merr përsipër dhe pajtohet të përbush detyrimet sinë vijim:

- 6.1. DKA pajtohet që të vë në në dispozicion resurset njerëzore dhe resurset materiale që i ka nën menaxhim për studentët dhe mbikëqyrësit e tyre nga Fakulteti i Edukimit, me qëllim të realizimit të mësimit praktik të paraparë me skemën programore të Fakultetit të Edukimit.
- 6.2. DKA pajtohet që të vë në në dispozicion, për t'i mentoruar studentet drejtpërdrejt në klasë, të gjithë rrjetin e mësuesve/edukatorëve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit, si dhe ata që do të certifikohen në të ardhmen.
- 6.3. DKA pajtohet të sigurojë që drejtorët e shkollave dhe enteve parashkollore të tregojnë gatishmëri për t'i pranuar studentët e sistemuar, të caktuar nga Fakulteti i Edukimit për të mbajtur mësimin praktik në institucionet që janë nën menaxhimin e tyre.
- 6.4. DKA pajtohet që të sigurojë që drejtorët e shkollave dhe enteve parashkollore të luajnë rolin përkrahës në ofrimin e mbështetjes rreth organizimit të mësimit praktik dhe të lehtësojnë bashkëpunimin e mësimdhënësve mbikëqyrës nga Fakulteti i Edukimit dhe mentorëve në shkolla dhe ente parashkollore.

Neni 6

Marrëveshja hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Gjilan, më 15.12.2020

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA", GJILAN

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Rektor

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT, FERIZAJ

Z. Afrim Llabjani

Drejtor